



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/147
Datë: 14.06.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 qershor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për pozitat e 2 (dy) anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës këta kandidatë:
 - 1.1. Arta Qorolli-Isufi;
 - 1.2. Drita Desku;
 - 1.3. Adnan Preniqi;
 - 1.4. Arjeta Pajaziti-Qerimi;
 - 1.5. Kujtim Hoxha;
 - 1.6. Naim Sahiti.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që emrat dhe biografitë e të propozuarve nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/147
Datë: 14.06.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 12 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyjet, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 qershor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për bartje të së drejtës së shfrytëzimit, përkatësisht ndryshimit të shfrytëzuesit në ngastrat kadastrale sipas Shtojcës të këtij Vendimi, në sipërfaqe prej 5 hektarësh sipas koordinatave të parapara në këtë Shtojcë, në dobi të interesit publik.
2. Përfitues i të drejtës së shfrytëzimit të ngastrave sipas pikës 1. të këtij Vendimi, është Ministria e Shëndetësisë.
3. Bartja e të drejtës së shfrytëzimit, sipas pikës 1. të këtij Vendimi, bëhet me qëllim të ndërtimit të objekteve për nevojat e dy (2) Institucioneve:
 - 3.1. Instituti Special Shtime; dhe
 - 3.2. Qendra Rehabilituese e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime.
4. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht Agjencia e Pyjeve të Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përkatësisht Agjencia Kadastrale e Kosovës si dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca I- Kopja e Planit dhe njësia kadastrale




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
 MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : SHTIME
 Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Zborc

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-72809031-00434-0	Parcelë / Parcela / Parcel	511400



Shkalla/Razmera/Scale: 1:10303

Punoi/Obradio/Created:
 Data/ Data/Date: 10.05.2023
 Koha/ Vreme/ Time: 03:08:51
 Nënshkrimi/Potpis/Signature:
 Shënim/Beleška/Note:

[Handwritten signature]



Aprovi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

[Handwritten signature]



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY



CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72809031-00434-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	840/23
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	10.05.2023 - 15:07
Komuna / Opština / Municipality:	SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Zborc / Zborce / Zborc
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësimit kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësimit Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-72809031-00434-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		511400			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
MALET E ZBORCIT				

Printuar nga / Odstampani od / Printed by: Kadrije.Zeqa | P-72809031-00434-0

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

1 / 2



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenuto koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvaliteti klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area (m ²)
1	Pyjorë/sumsko/Forestry	Tokat Pyjore/sumsko zemljište/Forest	Mal I Klasës 3/Suma 3 Klase/3rd Class Forest	511400

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Dea imovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posehim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	PASURI SHOQËRORE E PYJEVE	KCID914107452	FERIZAJ / UROŠEVAC / FERIZAJ /			1/1		

Shtojca II. Skicat dhe koordinatat e parcelës

Koordinatat per parcelen
00434-0

nr.	y	x
1	7500811.691	4702234.428
2	7500731.092	4702400.812
3	7500965.064	4702516.961
4	7501053.164	4702353.652
5	7501027.684	4702340.718
6	7501017.959	4702334.591
7	7501011.249	4702330.021
8	7500972.155	4702311.642
9	7500958.053	4702303.084
10	7500920.166	4702281.957
11	7500897.174	4702269.145
12	7500882.197	4702261.267
13	7500846.701	4702248.43
14	7500830.752	4702241.624
15	7500824.139	4702238.998



Z.K.ZBORC

SKICA E NDARJES

434-0

905.0

Pjese e ngas nr. 434-0
me sip. arej 5 ha

Shpreh1 - Import | 2 |




Autodesk Professional...



Z.K.ZBORC

SKICA E NDARJES



Sheet1 - Import Sheet1 - Import [2]




Media Profession...



Z. K. ZBORČ

SKICA EN DARJES




BORC


SKICA E NDARJES

434-0

Plese e ngasit 434-0
me sip. prej 5 ha

434-0






Z. K. ZBORC

SKICA E NDARJES

434-0

Pjesë e ngas. nr. 434-0
me sip. prej 5 ha

995-0





ZK. ZBORO

SKICA E NDARJES





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/147
Datë: 14.06.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 22 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 qershor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Bordi i përkohshëm të drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës Sh. A. (shkurt "NKEC", tutje "Ndërmarrja") me këtë përbërje :
 - 1.1. Z. Alban Krasniqi, kryesues;
 - 1.2. Znj. Elvisa Destanović, anëtare;
 - 1.3. Znj. Dhurata Gutaj, anëtare;
 - 1.4. Z. Ismet Vrapqani, anëtar.
2. Obligohet Bordi i përkohshëm i drejtorëve të Ndërmarrjes të kryej detyrat dhe përgjegjësitë sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme të Ndërmarrjes.
3. Mandati i Bordit të përkohshëm të drejtorëve nuk mund të zgjasë më shumë se 6 (gjashtë) muaj dhe nuk mund të vazhdohet.
4. Caktohet kompensimi i anëtarëve të bordit të përkohshëm të drejtorëve në lartësinë e përcaktuar për kategorinë III të ndërmarrjeve publike qendrore nga Vendimin e Qeverisë Nr. 07/81 të datës 23 mars 2016, përderisa i njëjti është në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 02/68 i datës 9 tetor 2018 për lartësinë e kompensimit të anëtarëve të bordit të drejtorëve të Ndërmarrjes.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/147
Datë: 14.06.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 paragrafi 1. nenit 19 paragrafi 2 dhe 3, nenit 43 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 22 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 qershor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Shkarkohet Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore, Kompania për Menaxhimin e Deponive Sh. A.
2. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr.12/96 i datës 14 shtator 2022.
3. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore, Kompania për Menaxhimin e Deponive Sh. A. në këtë përbërje:
 - 3.1. Z. Izja Mjeku, kryesues;
 - 3.2. Znj. Arlinda Nallbani, anëtare;
 - 3.3. Z. Besnik Aliu, anëtar;
 - 3.4. Znj. Valbona Fazliu-Xheladini anëtare.

A r s y e t i m

Arsyet e shkarkimit të Bordi të Drejtorëve të NP KMDK Sh. A. i emëruar me Vendimin e Qeverisë Nr.12/96 të datës 14 shtator 2022, janë të sqaruara në Memorandumin Shpjegues të Ministrisë së Ekonomisë, të datës 7 qershor 2023.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

MEMORANDUM SHPJEGUES

për propozim-vendimin e Qeverisë për shkarkimin e bordit të drejtorëve dhe emërimin e bordit të përkohshëm të drejtorëve të ndërmarrjes publike qendrore “Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë” (KMDK) ShA

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK) ShA është ndërmarrje publike qendrore, në pronësi të plotë të Republikës së Kosovës.

Bordi i drejtorëve i Ndërmarrjes është emëruar me Vendimin nr. 12/96 të Qeverisë të 14 shtatorit 2022. Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike (NjPMNP), që vepron në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, ka monitoruar punën e bordit të drejtorëve dhe të Ndërmarrjes në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përmes shkresës së 26 majit 2023, NjPMNP ka njoftuar se bordi i drejtorëve të Ndërmarrjes është përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet si vijon:

- Komisioni i auditimit i Ndërmarrjes, i përbërë nga tre anëtarë të bordit të drejtorëve, i ka vazhduar mandatin zyrtar të auditimit të brendshëm pa konkurs, çka bie ndesh me nenin 21.4 të Ligjit për ndërmarrjet publike, i cili parasheh “procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese” për përzgjedhjen dhe emërimin e zyrtarëve;
- Ndërmarrja është vonuar në aplikimin për pëlqime mjedisore dhe dy herë ka dhënë informata të gabuara dhe jo të plota për shpronësimin e pronave të paluajtshme, që kërkohen për realizimin e projektit “Menaxhimi i mbeturinave të ngurta II–IV”, në vlerë prej 53 milionë euro, i financuar nga banka zhvillimore e Republikës Federale të Gjermanisë “KfW”, duke rrezikuar realizimin e projektit;
- Bordi i drejtorëve ka dështuar të ndërmarrë veprime konkrete për ristrukturimin e Ndërmarrjes dhe për të siguruar qëndrueshmërinë operative e mjedisore;
- Bordi i drejtorëve ka dështuar të funksionojë si një trup e vetme, në mungesë të një konsensusi themelor dhe bashkëpunimi efektiv në mes të anëtarëve.

Katër anëtarë të Bordit të Drejtorëve të emëruar me vendimin nr.12/96 të datës 14.09.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës në ndërmarrjen publike qendrore “Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë” (KMDK) ShA, janë dorëhequr.

Mbështetur në këto gjetje, NjPMNP ka konstatuar se bordi i drejtorëve të Ndërmarrjes ka shkelur detyrat fiduciare dhe nuk ka përmbushur përgjegjësitë e parapara me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative. Andaj NjPMNP ka rekomanduar shkarkimin e bordit të drejtorëve të Ndërmarrjes.

Neni 19 i Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe i ndryshuar me nenin 11 të Ligjit nr. 04/L-111, i kërkon Qeverisë të shkarkojë anëtarët e bordit të drejtorëve në këto raste:

- NjPMNP konstaton se anëtarët e bordit kanë shkelur detyrat fiduciare (neni 19.2, i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-111, neni 11);
- aksionari, i përfaqësuar nga Qeveria dhe Ministria e Ekonomisë, ka “arsye për të besuar” se anëtarët e bordit kanë shkelur detyrat fiduciare (neni 19.3).

Termi *detyrë fiduciare*, i huazuar nga anglishtja, përkufizohet si detyrë për të vepruar me ndershmërinë e besnikërinë më të lartë ndaj ndërmarrjes dhe në interesin më të mirë të saj.

Sipas nenit 17.2 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, “kryesuesi është përgjegjës për udhëheqjen e Bordit, duke siguruar efikasitetin e tij në të gjitha aspektet e rolit të tij dhe vendosjen e agjendës së tij.”

Rrjedhimisht, mbështetur në nenet 19 dhe 43 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Ministria e Ekonomisë propozon që Qeveria të shkarkojë bordin e drejtorëve të Ndërmarrjes, përkatësisht anëtarët e mbetur Avni Ramadani dhe Mirlinda Ahmeti, dhe të emërojë një bord të përkohshëm. Bordi i përkohshëm shërben deri në emërimin e bordit me mandat të rregullt, por jo më gjatë se gjashtë muaj.